



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.09.2019, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatjona Dhimitri - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 8, 9, 10, 11, 15 dhe 16 korrik 2019
2. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 2 - 20 shtator 2019
3. Miratimi i Vendimit nr. 10/1 për plotësimin e një vendi vacant në Këshillin Drejtues të RTSH.

**Marrin pjesë:**

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhambulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Ramazan Gjuzi.

**Mungojnë:**

Enada Kapllani.

## HAPET MBLEDHJA

**Fatjona Dhimitri** - Përsëritje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës të komisionit për këtë sesion parlamentar! Ju uroj punë të mbarë në vijimësinë e detyrave që ka komisioni!

Sot, në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 8, 9, 10, 11, 15 dhe 16 korrik 2019 dhe diskutimin dhe miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 2-20 shtator 2019.

A ka ndonjë objeksion lidhur me procesverbalet?

Po, urdhëroni!

**Milva Ekonomi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirë se erdhët të gjithë në këtë seancë të fillimit të punës së komisionit për sesionin e 5-të të kësaj legjislature! Në fakt, unë i kam lexuar me shumë kujdes procesverbalet, në përgjithësi kam dhënë komente për ndryshime shumë të vogla gjuhësore, kur ka pasur nevojë, kam diskutuar edhe me këshilltarin tonë juridik për disa nga procesverbalet. Në një procesverbal, nëse ju kujtohet, kur kemi thirrur këtu në seancë dëgjimore ministren e Arsimit lidhur me ligjin “Për Akademinë e Shkencave”, momenti kur e kemi miratuar në parim nuk është shkruar për arsye të moshapjes së mikrofonit. Kështu që mendoj se është detyrë e komisionit të ketë vëmendje që këtë gjë ta shtojë në procesverbal. Nuk e di se si mendojnë kolegët dhe nëse e kanë parasysh momentin kur mbaroi dëgjesa, që ne kërkuam të miratohej në parim projektligji “Për Akademinë e Shkencave”, por do t’i lutesha Arianës që ta formulojmë bashkë një fjali të shkurtër, për të vënë në dukje këtë veprimtari që kemi kryer gjatë procesit të diskutimit të projektligjit.

**Fatjona Dhimitri** – Faleminderit!

Vijojmë me punën në komision!

Në proces të këtij komisioni kemi projektligjin “Për Rininë”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Diskutimi nën për nën dhe në tërësi nuk është i përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 2-20 shtator 2019.

Në zbatim të vendimeve nr. 5 dhe nr. 5/1 për tri vakancat në Këshillin Drejtues të RTSH-së numri është plotësuar dhe kemi seanca dëgjimore me tri kandidatët, vende të pozitës dhe opozitës. Gjithashtu, kemi vendimin nr. 10 për një vend vakant në Këshillin Drejtues të

RTSH-së, për të cilin nuk u paraqit numri i duhur i kandidatëve, për pozicionin e Sajmir Kumbaros nga opozita, mandat i cili ka mbaruar në fillim të qershorit, kështu që duhet vendosur në vijim të punës në komision nëse duhet rishpallur apo duhet shtyrë.

Kemi vendimin nr. 11 për një vend vakant në AMA, pas shkarkimit të zotit Zylyftar Bregu; afati ishte më 4 gusht, por është shtyrë për datën 11 shtator 2019.

Kalendari i Kuvendit për periudhën 2-20 shtator 2019.

Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11256, datë 08.08.2019, “Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, depozituar më 09.08.2019, do të diskutohet në seancën plenare të datës 19.09.2019.

Për projektligjin “Për censin e popullsisë dhe banesave” të depozituar në datë 07.12.2018, ne jemi komision për dhënie mendimi, ndërsa komision përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

Në programin e Kuvendit për periudhën 2 shtator -18 tetor 2019 kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar” i depozituar më 09.07.2019, ku komisioni ynë është komision përgjegjës; projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, të depozituar në datë 19.07.2019 komisioni ynë do të jetë komision për dhënie mendimi, kurse komision përgjegjës do të jetë Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Në kalendarin e Kuvendit është përfshirë si i mbartur edhe projektvendimi për zgjedhjen e tri anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së, të depozituar në datën 4 shkurt 2019, por ka mbetur i bllokuar në seancë.

Gjithashtu, në sesionin e kaluar është depozituar pranë komisionit tonë edhe kërkesa për seancë dëgjimore me Shoqatën e Botuesve të Shqipërisë, kërkesë e cila do të jetë në planin tonë të punës për këtë sesion parlamentar.

Po, urdhëroni!

**Milva Ekonomi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë besoj se do të kem mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të komisionit! Të paktën në veprimtarinë që ka komisioni në muajt shtator dhe tetor, duhet të bëjmë kujdes që të thërresim në seancë dëgjimore ministren e Arsimit, për të marrë njoftim në lidhje me mbarëvajtjen e fillimit të procesit mësimor si për arsimin parauniversitar, ashtu dhe për atë universitar, dhe bashkë me dëgjuesin që bëjmë me ministren e Arsimit, bëjmë dëgjuesë edhe me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, e cila është përgjegjëse për arsimin profesional. Prandaj, mendoj

që në këtë kalendar të veprimtarisë të shtojmë edhe këto 2-3 dëgjesa, që lidhen me mbarëvajtjen e vitit shkollor në Republikën e Shqipërisë.

**Fatjona Dhimitri** – Atëherë, vijojmë me përcaktimin e datës së shqyrtimit të dekretit të Presidentit në komisionin tonë. Sipas Rregullores së re të miratuar në sesionin e shkuar parlamentar, dekretet e Presidentit do të shqyrtohen brenda 4 javëve nga momenti i depozitimit.

A ka ndonjëri ndonjë mendim lidhur me datën e shqyrtimit të tyre, që më pas ta hedhim në votim? Kush e do fjalën?

**Milva Ekonomi** – E vetmja gjë që mendoj se duhet të kemi parasysh është të marrim Rregulloren e re, të shohim si janë kërkesat për të depozituar mendime lidhur me organizimin e seancës plenare dhe të bëjmë kalendarin e punës për komisionin tonë. Ne jemi njohur me shkresën që ka sjellë Presidenti, e kemi të gjithë në dosje, dhe besoj se do të jetë shumë e domosdoshme për ne të kemi prezent këtu pjesën juridike të parlamentit. Të vijë dikush nga Shërbimi Juridik i parlamentit, sepse çështjet që ngrihen kanë nevojë për interpretim ligjor. Unë besoj se komisioni nuk është i aftë ta diskutojë i vetëm kthimin e përgjigjes së dekretit të Presidentit, pa mbështetjen e Shërbimit Legjislativ.

**Fatjona Dhimitri** – Gjatë diskutimit të projektligjit “Për Rininë” në sesionin e shkuar parlamentar, u pezullua procedura e shqyrtimit për shkak të disa problemeve me ligjshmërinë, me mënyrën e strukturimit apo me ndërtimin e projektligjit.

Datat kur mund të shqyrtohet projektligji “Për Rininë”...

**Milva Ekonomi** – E vendosni ju në mbledhjen e kryetarëve. Nuk i kemi këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Muhamet Bela** – Ju lutem, a ka mundësi të flas?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dekreti i Presidentit është në kalendar. Për projektligjin “Për Akademinë” raporti duhet të shkojë një javë më parë, sipas rregullores së re.

**Fatjona Dhimitri** - Të njëjtën gjë e thamë edhe ne. Ne do të vendosim datën kur do ta shqyrtojmë në komisionin parlamentar dhe, më tej, do të çohet në seancë.

**Milva Ekonomi** – Raportin duhet ta kemi gati të hënën apo të premten?

**Fadil Nasufi** – Unë sugjeroj që të mërkurën të bëjmë mbledhje.

**Fatjona Dhimitri** – Të vendosim bashkërisht kur do të zhvillohet mbledhja.

**Fadil Nasufi** – Më pas të punohet me raportin, sepse duhet një javë më parë.

**Fatjona Dhimitri** – Për sa i përket projektligjit “Për Rininë”, sërish datat e shqyrtimit të tij, do të përcaktohen bashkërisht nga komisioni.

Urdhëroni!

**Ismet Beqiraj** – Përshëndetje!

I uroj punë të mbarë komisionit për këtë sesion!

Unë e mbështes propozimin që bëri kolegu Nasufi, që kryesia e komisionit, duke u mbështetur në kalendarin e punimeve të parlamentit, t'i draftojë, sidomos ligjet apo projektligjet, që janë vendosur në axhendën e periudhës që kaluam, në seancën e kaluar. Kryesia t'i draftojë dhe të bëjë shpërndarjen, sepse nuk më duket racionale të rrimë sot për të vendosur datën.

**Fatjona Dhimitri** – Sot ne prezantuam të gjitha detyrimet apo objektivat që do të ketë komisioni në punën tonë në vazhdim.

Datat do t'i vendosim bashkërisht.

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem!

Jam dakord t'i vendosim bashkërisht, por do të ishte mirë që kryesia e komisionit t'i paraqesë datat dhe të thotë: ne mendojmë të fillojnë dëgjesat për projektligjin “Për Rininë” në këto data. Ky është diskutim, jo të vendosen datat! Nuk mund t'i vendosim datat ne të gjithë, si komision.

**Fatjona Dhimitri** – Dakord, do t'i propozojmë datat përkatëse.

Për vakancat e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar do të realizohen dëgjesat për tri vendet vakante të maxhorancës.

Për vendin vakant, në të cilin qëndron ende në detyrë zoti Saimir Kumbaro ...

**Milva Ekonomi** – Do të marrim vendim për ta rishpallur.

**Fatjona Dhimitri** – Kush është dakord për rishpalljen e vendimit?

Dakord.

Atëherë miratohet Vendimi nr. 10/1 për rishpalljen e vakancës së një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Për vendin vakant të AMA-s?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është shtyrë deri më 11 shtator.

Për sa i përket projektligjit “Për censin” jemi komision për dhënie mendimi, kështu që do të rakordojmë me Komisionin përgjegjës të Ekonomisë dhe Financave për të përcaktuar edhe datën e dhënies së vendimit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për Mediet Audiovizive”, në momentin kur të dyja palët e komisionit, maxhoranca dhe opozita, do të draftojnë datat e shqyrtimit të projektligjeve, atëherë do t'i kalojmë në komision.

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, jemi komision për dhënie mendimi dhe do të rakordojmë me Komisionin përgjegjës të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit për të shpalosur më tej edhe mendimin tonë për projektligjin.

Për sa i përket kërkesës për seancë dëgjimore nga Shoqata e Botuesve të Shqipërisë, e cila u paraqit në sesionin e shkuar parlamentar, për datën e shqyrtimit të kësaj kërkesë do të vendosim, pas draftimit të kalendarit të punimeve nga komisioni ynë.

Urdhëroni, zonja Kumbaro!

**Mirela Kumbaro** - Cila është tema e takimit, e kërkuar nga botuesit?

**Fatjona Dhimitri** – Problematikat kryesore që ka Shoqata e Botuesve.

Besoj se sekretaria e komisionit e ka depozituar kërkesën e Shoqatës së Botuesve pranë secilit anëtar të komisionit, do të merret në shqyrtim.

Urdhëroni!

**Mirela Kumbaro** – A mund të kërkojmë një axhendë të tematikës, sepse ndihmon për ta bërë takimin më efikas?

**Fatjona Dhimitri** – Në ditët në vijim, do të kemi të gjitha datat e projektligjeve që do të shqyrtohen, qoftë ato që janë për dhënie mendimi, qoftë ato që janë për komision përgjegjës.

**Mirela Kumbaro** – Jo, nuk e kam fjalën për datat, por meqenëse është një temë që më intereson, dua t’i kemi më të detajuara problematikat.

**Fatjona Dhimitri** – Dakord.

Sekretariati i komisionit do të depozitojë pranë secilit anëtar të gjitha materialet e domosdoshme për shqyrtimin e projektligjeve, si dhe të gjitha materialet e kërkesave që janë paraqitur pranë nesh për seanca dëgjimore.

A ka dikush nga anëtarët e komisionit diçka për të shtuar për mbledhjen e sotme?

Po, urdhëroni.

**Milva Ekonomi** – Unë do të shtoja diçka për Rregulloren e re që ka miratuar Kuvendi për veprimtarinë tonë gjatë aktivitetit parlamentar. Të mos harrojmë si e kemi ciklin. Kemi cikël 3 javë në Kuvend dhe në komisione dhe kemi 1 javë të gjelbër. Pas javës së gjelbër, rikthehemi për të referuar problemet e zonës dhe do të kemi sërish seancë të enjten e asaj jave.

Kështu, duke pasur parasysh këtë situatë, për secilin nga ne duhet të jetë e qartë që kemi 3 javë punë, 1 javë në zonat tona elektorale dhe 1 javë tjetër duhet të marrim në konsideratë shënimet e zonave përkatëse dhe projektligjet që kemi këtu. Pra, ngarkesa do të jetë më e madhe. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë edhe faktin se të gjitha raportet për projektligje apo për situata të ndryshme, që mund të ketë komisioni, duhet të depozitohen katër ditë përpara,

nga dy ditë që ishte më parë. Për këtë arsye, kalendari i punës do të jetë shumë i ngjeshur, prandaj kam përshtypjen se kur ne t'i propozojmë Kryesisë oraret për mbledhje, duhet të jeni të gatshëm për të marrë pjesë, në mënyrë që të plotësohet kuorumi dhe të vazhdojmë mbledhjen. Pra, kemi Rregullore të re, afate të reja dhe detyra të reja, ndaj duhet ta miratojmë me vendosmëri kalendarin.

**Fatjona Dhimitri** - Para se të mbyllim mbledhjen, a ka ndonjë mendim apo sugjerim tjetër për vijueshmërinë e punës së komisionit? Nuk ka.

Atëherë, në ditët në vazhdim do të vendosim për vijueshmërinë e punës së komisionit, për datat kryesore të shqyrtimit të projektligjeve.

Sekretariati duhet t'u dërgojë të gjitha materialet me *e-mail* të gjithë anëtarëve të komisionit.

Faleminderit!

Faleminderit edhe medieve!

**MBYLLET MBLEDHJA**